



Prishtinë / Priština

Nr./Br. 762-2017

Në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 64.2 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë 29.05.2017, nxjerr këtë:

VENDIM

Për Miratimin e Udhëzimit për Anëtarët e Këshillave të Vendvotimit

- I. Miratohet Udhëzimi për Anëtarët e Këshillave të Vendvotimit, për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës, që do të mbahen me 11 qershor 2017.
- II. Udhëzimi si në pikën I të këtij vendimi, është pjese përbërëse e këtij vendimi.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 29.05.2017

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve





Zgjedhjet qendrore 2017

Asistenca për votuesit me aftësi të kufizuara

Udhëzime për Anëtarët e Këshillave të Vendvotimit

INFORMATË E PËRGJITHSHME

- Votuesi **mundet** të ndihmohet nga:
 - Një votues tjetër;
 - Përfaqësuesit e mediave në vendvotim.
- Votuesi **nuk mundet** të ndihmohet nga:
 - Ndonjë anëtar i Komisionit;
 - Ndonjë kandidat për zgjedhje;
 - Vëzhguesit.

GJËRAT QË DUHET TË MERRREN PARASYSH PËR TË GJITHA LLOJET E AFTËSIVE TË KUFIZUARA

- Duhet të ndihmoni, por kurrë mos shprehni keqardhje;
- Diskutoni me personin me aftësi të kufizuar drejtpërdrejtë, e jo me shoqëruesin;
- Duhet të jeni të njoftuar me udhëzimet se si votohet, prandaj duhet të jeni të gatshëm për t'ia shpjeguar dhe/ose demonstruar procesin e votimit;
- Kurrë nuk duhet të supozoni se si ai/ajo preferon të votojë;
- Duhet ta pyesni votuesin se kush dëshiron që ta ndihmojë;
- Nuk duhet të pyesni votuesin se për kë voton;
- Duhet ta respektoni të drejtën e votuesit për fshehtësi dhe privatësi gjatë gjithë kohës.

KONSIDERATA PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA SHQISORE

- Nëse votuesi i verbër ka nevojë për ndihmë për lëvizje nëpër vendvotim, qëndroni pranë tij/saj, kërkoni që t'ju kapë për dore;
- Vendosni fletëvotimin e rregullt në shabllonin e fletëvotimit në Braille, dhe vendosini ashtu që personi i verbër të mund të futet në kabinën e votimit dhe të votojë vet.
- Flisni qartë dhe ngadalë me personat me vështirësi në dëgjim. Nëse nevojitet, lexoni me zë dhe sqaroni të gjitha opsionet e fletëvotimit ose pyetjet në lidhje me fletëvotimin;
- Shkruani në letër ato çka komunikoni nëse votuesi tregon se ka probleme me dëgjimin ose nuk mund të komunikojë me fjalë;
- Nëse interpreti i gjuhës së shenjave është i pranishëm, komunikoni me anë të tij/saj.

KONSIDERATAT PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA FIZIKE

- Shtegu për tek kutia e votimit duhet të jetë i pastër, dhe vendvotimi të organizohet sipas udhëzimit në foto;
- Nëse biseda me një përdorues të karrocës zgjatë më shumë se një minutë, uluni dhe flisni ballë për ballë;
- Mos u mbështetni për karrocë.

